



Afatet e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimit: Master i Shkencave, Master Profesional, Master i përbashkët:

PROGRAM I PARË STUDIMI 2025-2026

Periudhat Referencë në “Urdhër i përbashkët QSHA-QNRRASH për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL, viti akademik 2025-2026, Kreu VII”	Afatet e përfundimit dhe data e realizimit
Data e hapjes së aplikimeve	1 shtator 2025
Data e mbylljes së aplikimeve	03 tetor 2025
Shpallja e aplikantëve fitues të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara	17 tetor 2025
Ankimimi	Brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve
Regjistrimi i fituesve	20.10.2025 - 27.10.2025
Plotësimi i kuotave të mbetura bosh, sipas kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe	28.10.2025 - 30.10.2025
Shpallja e listave emërore të kandidatëve të regjistruar	31 tetor 2025
DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM pranë Sekretarisë Mësimore të Ciklit të Dytë	nga e hëna në të enjte: 08:00 – 16:30 e premte: 08:00-14:30

PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË FGJH-UT KU MUND TË APLIKONI:

- Master i Shkencave në **Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik Trigjuhësh** në degët *Gjuhë Angleze, Italiane, Gjermane, Frënge, Spanjolle, Greke, Turke.*
- Master i Shkencave në **Mësuesi e Gjuhës së Huaj për arsimin e mesëm të lartë,** në degët: *Gjuhë Angleze, Italiane, Gjermane, Frënge, Greke, Turke.*
- Master i Shkencave në **Përkthim-Teknik Letrar dhe Interpretim,** në degët: *Gjuhë Angleze, Italiane, Gjermane, Frënge, Spanjolle, Ruse, Greke, Turke.*
- Master Profesional në **Përkthim me profil Përkthyes**
- Master i Shkencave, diplomë e dyfishtë me UNIVERSITETIN SORBONNE PARIS NORD **“Trajtimi Informatik dhe Gjuhësor i Dokumenteve të Shkruara”**